



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtruesi i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 89-të, të mbajtur më 20.07.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-5937/1 të datës 16.06.2022 me pretendime për pakënaqësi nga veprimet e institucioneve dhe me kërkesë për kompensim të personit fizik nga -----, **HIDHET POSHT**. KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e LPKKI nuk ka elemente për veprim kompetent sipas lëndës.

Lënda me numër 12-5937/1 të datës 16.06.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Një kërkuar i njohur, më datë 16.06.2022, ka dorëzuar denoncim të regjistruar me numër 12-5937/1, datë 16.06.2022, pas së cilës është ngritur rasti me pretendime për pakënaqësi me veprimet e institucioneve dhe me kërkesë për dëmtshpërblim për personin fizik nga ----- . Në denoncimin e dorëzuar thuhet se parashtruesi, si fermer individual i cili merrej me kultivimin e patates, ka pasur problem me shkatërrimin e plantacionit nga bagëtisë e të tjerëve dhe i cili plantacion ishte mbjellë në arat në pronësi të tij dhe në tokë shtetërore të marrë me qira. Në vitin 2021 e ka publikuar rastin në portalin MKD dhe i është drejtuar Inspektoratit Shtetëror për Bujqësi për konstatimin e dëmit të shkaktuar, pas së cilës inspektorati ka kryer kontroll më 13 gusht 2020 dhe ka konstatuar dëme në disa ara në vlerë prej 20- 40% e të korrave të patates. Më pas, parashtruesi ka raportuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme ----- e cila ka shkuar në vendngjarje më datë 23.05.2021 dhe ka përgatitur kallëzim dhe personi që ka në pronësi bagëtinë për të mos shkuar në gjykatë, ka nënshkruar deklaratat se do t'ia paguajë dëmin e shkaktuar parashtruesit, por nuk ka bërë të njëjtën gjë deri më sot, ndaj ka mbetur i dëmtuar dhe kërkon të kompensohet.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, KSHPK konkludoi se rasti kishte të bënte me shkeljen e të drejtës individuale të parashtruesit për të cilën vepronin autoritetet e tjera kompetente, dhe në lidhje me kërkesën për kompensim për dëmin e shkaktuar, parashtruesi mund të kishte ushtruar të drejtën e tij. para një organi tjetër kompetent për të vepruar (gjykata kompetente), gjë që nuk është bërë prej tij dhe mbi këtë bazë nuk është nisur asnjë procedurë gjyqësore.

Nga sa u tha mē lartē, KSHPK-ja vlerēsoi se organi tjetēr ēshtē kompetent pēr tē vepruar, pas sē cilēs konstatoi se nē rastin nē fjalē nuk ka elemente pēr veprim kompetent dhe vendosi si nē dispozitiv tē kētij vendimi.

**KOMISIONI SHTETЌOROR
PЉR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**

**Kryetar,
Biljana Ivanovska**

Dorēzuar:

- Parashtruesi i denoncimit

Pērgatiti: J.C,

Miratoi: Mr. V:G, anētar i KSHPK-sē

